



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLICA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION

22 -03- 2021

Ref. 2103/362/BA/y.f



Nr.13/2021

Bordi për Ankesa, i përbërë nga Ylber Fetahaj, kryetar dhe Avdyl Hyseni e Ilaz Rudaku anëtarë, lidhur me Ankesën me numër Ref:2103/281/BA/y.f të datës 05.03.2021 të parashtruesit “TE 7” SH.P.K të përfaqësuar nga avokatët Arianit Koci dhe Granit Vokshi me adresë në rrugën Robert Dollu, nr.34, Prishtinë, të paraqitur ndaj Vendimit Ref:2102/165/KPM/xhl, të datës 11.02.2021 të Komisionit të Pavarur të Mediave (KPM), Bordi për Ankesa në seancën e mbajtur me datën 12.03.2021 mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pa bazuar Ankesa Ref:2103/281/BA/y.f të datës 05.03.2021 të parashtruesit “TE 7” SH.P.K dhe të përfaqësuar nga avokatët Arianit Koci dhe Granit Vokshi, me adresë në rrugën Robert Dollu, nr.34, Prishtinë, dhe mbetet në fuqi Vendimi Ref:2102/165/KPM/xhl, i datës 11.02.2021 i Komisionit të Pavarur të Mediave.

A r s y e t i m

Komisioni i Pavarur i Mediave me Vendimin Ref: 2102/165/KPM/xhl, të datës 11.02.2021, Palën përgjegjëse e ka sanksionuar me vërejtje në pajtim me nenin 30 paragrafi 1 të Ligjit Nr.04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, për shkeljen e nenit 14 paragrafi 5 të Rregullores KPM-2017/07 për Komunikimet Komerciale Audiovizuale

Kundër këtij Vendimi në afatin e paraparë ligjor “TE 7” SH.P.K ka parashtruar Ankesë Ref:2103/281/BA/y.f me datën 05.03.2021 pranë Bordit për Ankesa, për shkak të: zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, procedurave për vënien e sanksioneve dhe sanksionit të shqiptuar, me propozim që Bordi për Ankesa të aprovojë Ankesën si të bazuar në tërësi dhe të anulojë Vendimin e kundërshtuar.

Bordi për Ankesa, në seancën e mbajtur me datën 12.03.2021 ka shqyrtuar dhe analizuar të gjitha pretendimet ankimore të Palës ankuese “TE 7” SH.P.K, si dhe ka analizuar të gjitha provat tjera të

cilat kanë rezultuar me marrjen e Vendimit Ref:2102/165/KPM/xhl, të datës 11.02.2021 të Komisionit të Pavarur të Mediave.


Bordi për Ankesa konstaton se pretendimet e Palës ankuese lidhur me gjendjen faktike dhe shkeljen ligjore nga ana e Komisionit të Pavarur të Mediave, janë të pa bazuara, sepse Komisioni i Pavarur i Mediave, me rastin e marrjes së Vendimit të kundërshtuar e ka vlerësuar plotësisht gjendjen faktike, duke u bazuar në dispozitat materiale, përkatësisht në pajtim me nenin 14 paragrafi 5 të Rregullores KPM-2017/07.

Andaj, Bordi për Ankesa, bazuar në faktet e lartcekura, si dhe bazuar në nenin 44 paragrafi 1 të Ligjit Nr.04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, si dhe nenin 10 paragrafi 2 të Rregullores BA-2018/01 të Punës së Bordit për Ankesa, vendosi unanimisht si në dispozitivin e këtij vendimi.

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi mund të inicohet konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

- Palëve dhe
- Arkivit të KPM-së.



Ylber Fetahaj
Kryetar i Bordit për Ankesa